

Nr. 2437/10. Prot
Datë 18.06.2025



- Sp.b. bashkëpunimi Bashkiak
- J. Et'hem Beut

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. ~~397~~ Prot.
3

Durrës, më 13.06.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

SHIJAK

KRYETARIT TË BASHKISË

SHIJAK

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Shijak Nr.14 datë 30.05.2025 "Për azhormimin dhe saktësimin e listës së personave të pastrehë të cilët janë prekur nga zbatimi i projektit " Rindërtimi i shkollës Muharrem Dollaku" si dhe miratimi i bonus strehimi"

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" (neni 8/a) "Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore".

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMIL JAN JANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2457 Prot
4

Datë 02.06.2025

VENDIM NR 14 DATË 30.05.2025

Për azhurnimin dhe saktësimin e e listës së personave të pastrehë të cilët janë prekur nga zbatimi i projektit “Rindërtimi i Shkollës Muharrem Dollaku” si dhe miratimi I “Bonus Strehimi”

Këshilli Bashkiak bazuar në Ligjin Nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 8 pika 2 Neni 9 pika 1.1a dhe 1.1/5, Neni 30 pika 7, Neni 54/dh, Ligjin Nr 9232, datë 13.05.2004 “ Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” Të ndryshuar Neni 13, 14 , 15, 16, Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës , Vendimin Nr 574 datë 29.08.2012 “ Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njerit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të proceduarve të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, Udhëzim Nr 23 datë 30.12.2008 “Për përmbajtjen e bonusit të strehimit”, Vendim Nr 814 datë 03.12.2004 “ Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Vendimit Nr 1093 datë 28.12.2015 “Për miratimin e procedurave , kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit, të VKB Nr 38 datë 30.11.2016 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për grupet e familjeve të pafavorizuara për strehim” , VKB nr 15 datë 21.06.2017 “Miratimi i listës shumë emërore të familjeve të cilët përfitojnë statusin si të pastrehë” si dhe urdhërit të Kryetarit Nr 162 date 05.07.2021 .

VENDOSI:

- 1- Të miratojë listën e familjeve të paraqitur nga Bashkia Shijak;
- 2- Të miratojë “Bonusin Strehimi”;
- 3- Burimi i financimit të jetë nga të ardhurat e Bashkisë .
- 4- Ngarkohen Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Juridike për zbatimin e këtij vendimi.

Adresa:Lagja”Erzen”Shijak,
Tel”+3557122152,wwbsite:www.shijak.gov.al,email:info@shijak.gov.al

- 5- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT

Sulejman Tola



Adresa:Lagja"Erzen"Shijak,

Tel"+3557122152,wwbsite:www.shijak.gov.al,email:info@shijak.gov.al